



# Newsletter

## Numër 5



### Në Fokus

Infrastruktura në mbështetje të ekonomisë lokale

### Histori njerëzore

Qendra e Valbonës, si një inkubator multifunksional i turizmit!

### Të reja nga projektet

1. Rruga që furnizon më shpejt tregjet shqiptare

2. Investimet në infrastrukturë, akses në destinacionet turistike

### A e dini se?

Kalaja e Borshit, në histori prej shekullit të XIII-të

## Infrastruktura në mbështetje të ekonomisë lokale

Grupet lokale të interesit janë një ndër aktorët më të rëndësishëm, në procesin e hartimit dhe të planifikimit të një projekti infrastrukturor. Njësitë e qeverisjes lokale, sektori privat dhe shoqëria civile janë duke kërkuar praktikat më të mira, për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë lokale. Në këtë aspekt përmirësimi i infrastrukturës vihet në shërbim të aksesit më të shpejtë dhe më të lehtë.

Në zonat me prodhime bujqësore e blegtorale dhe me potenciale për zhvillimin e agroturizmit, infrastruktura siguron dalje në tregjet e qyteteve dhe nxitjen e mundësive të reja për investime. Në zonat me potencial turistik sjell rritjen e frekuentimit dhe përfshirjen e popullsisë në mundësi punësimi, përmes nxitjes së sipërmarrjeve private. Rrjedhimisht duke përmirësuar kushtet bazë të jetesës dhe ekonomive familjare.

Nga veriu në jug Shqipëria shfaq potenciale lokale të jashtëzakonshme për t'u eksploruar. Në këtë drejtim Fondi Shqiptar i Zhvillimit në bashkëpunim me shumë aktorë interesi (Qeveria, Institucionet Financiare, Partnerë etj) ka ndërmarrë projekte të reja në infrastrukturën vendore rajonale, me qëllim lidhjen e zonave rurale dhe urbane si një rrjet i rëndësishëm, për krijimin e iniciativave ekonomike, por edhe për prezantimin dhe ruajtjen e vlerave lokale tradicionale.



Këto projekte nuk trajtohen si “zgjdhje të shpejta afatshkurtra” apo si përmëshje e kërkesave më të fundit nga banorët. Në këto objekte krijohen strategji të mirëfillta për të identifikuar avantazhet e ofertës lokale, e cila bazohet në drejtime kryesore si:

- ✓ Ndërhyrje urbane dhe mjedisore;
- ✓ Rikualifikim urban;
- ✓ Rikualifikim i zonave me rëndësi historike e trashëgimi kulturore;
- ✓ Rikualifikim mjedisor;
- ✓ Infrastruktura në mbështetje të turizmit;
- ✓ Infrastruktura në mbështetje të prodhimit bujqësor dhe agropërpunimit;
- ✓ Investim në informacion dhe dije
- ✓ Krijimi dhe zhvillimi i të dhënave në bazë kombëtare të aksesueshmërisë nga institucionet qëndrore dhe lokale;
- ✓ Ndërhyrje në infrastrukturë dhe shërbime publike;
- ✓ Infrastruktura nëntokësore hidrike;
- ✓ Infrastruktura transporti;
- ✓ Infrastruktura në funksion të shërbimeve sociale;

Për më shumë info:

<https://www.albaniandf.org/2020/01/03/infrastruktura-ne-mbeshtetje-te-ekonomise-lokale/>

## Qendra e Valbonës si një inkubator multifunksional i turizmit

... “këta të Fondit na kanë vënë në lëvizje, kush ndërton shtëpizën më të bukur. Tani më ka vajtur mendja dhe një teleferik të shkurtër të ndërtoj ta lidh me kodrën aty, për ti sjellë njerëzit nga kodra direkt në bujtinë, kur mbarojnë ecjen”. *Banor i Valbonës*

“Kam bërë shumë foto, gjithçka këtu rreth e rrotull është shumë e paqtë. Sapo u ktheva hiking, përmes shtegut nga Theth për në Valbonë. Shtëpizat e drurit këtu duken shumë bukur, të rehatshme, si dhe të vendosura në vendin e duhur, nga ku shumë mirë mund të nisemi për të lëvizur në zonë. Do doja t’i shihja sërish kur të përfundojnë dhe pse jo të prenotoj, sepse që tani duken shumë mirë”. *Turist Kanadez në Valbonë*

Për më shumë info: <https://www.albaniandf.org/2019/10/25/qendra-e-valbones-si-nje-inkubator-multifunksional-i-turizmit/>



Të reja nga projektet

## Rruga që furnizon më shpejt tregjet shqiptare

Unaza Bujqësore e Myzeqesë integron investimet e kryera më herët duke përmirësuar ndjeshëm aksesin drejt tregut të Lushnjes, me qëllim nxitjen e prodhimit të bujqësore dhe krijimin e perspektivave për aktivitete të reja ekonomike.

Nga ky projekt përfitojnë rreth 6,700 ha tokë e kultivuar me 189 ha serra dhe 93 ha pemë. Unaza e re do të ketë 2 korsi për automjetet, 3,2 km trotuare për këmbësorë, si dhe infrastrukturë nëntokësore për kanalizimet e ujërave dhe ndriçimit. Në shërbim të drejtëpërdrejtë për 15 mijë banorë, kjo vepër infrastrukturore financohet nga Qeveria Shqiptare në zbatim nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Për më shumë info:

<https://www.albaniandf.org/2020/01/10/rruga-qe-furnizon-me-shpejt-tregjet-shqiptare/>

Tashmë produkti do të përdorë këtë rrugë për të arritur tregjet më shpejt dhe me kosto më të ulët. Aktualisht ka përfunduar Lot 1 - Ngurrëz - Kashtbardhë dhe po vijojnë punimet në Lotin 2 Qerret - Kadiaj - Saver.





## Investimet në infrastrukturë, akses në destinacionet turistike

Fshati Tushemisht ndodhet vetëm 6 km larg Pogradecit, ku “Zonja nga qyteti”, Parku Natyror i Drilonit dhe peizazhi piktoresk i zonës mirëpresin vizitorë vendas dhe të huaj.

Tashmë ky destinacion do të arrihet më shpejt dhe më lehtë, pasi rruga lidhëse mes tyre është në proces rikonstruksion në kuadër të programit “Rrugët Lidhëse Rajonale”, me financim të Qeverisë Shqiptare, Bankës Botërore dhe BERZH.

Pogradec - Tushemisht është pjesë e rëndësishme e infrastrukturës së bashkisë Pogradec. Është segment rruge lidhëse e qytetit Pogradec me fshatin Tushemisht dhe doganën e Tushemishtit, por duke shërbyer gjithashtu dhe si rrugë e brendshme.

Për më shumë info:

<https://www.albaniandf.org/2020/01/15/investimet-ne-infrastruktura-akses-ne-destinacionet-turistike/>

Rruga ecën paralelisht me liqenin e Dritës” (liqeni i Ohrit - Lyhnidas), duke ofruar një pamje mbresëlënëse. Realizimi i këtij objekti pritet të sjellë ndikim pozitiv në turizëm përmes rritjes së bizneseve të vogla dhe shërbimeve që ofron industria e turizmit. Duke përmirësuar ndjeshëm jetesën e banorëve si dhe frekuentimin e lartë të zonës nga vizitorë vendas dhe të huaj.



A e dini se?

## Kalaja e Borshit, në histori prej shekullit të XIII-të

Kalaja ka një pozitë të rëndësishme strategjike, pasi është pranë njërës nga dy grykat që përshkonin në lashtësi malet Akrokeraune, (në mesjetë - malet e Himarës), duke lidhur bregdetin me brendësinë e vendit.

Për shkak të amortizimit ndër vite të aksit Borsh-Kalaja e Borshit, ajo nuk ka marrë vëmendjen e merituar nga vizitorët. Sot ky aks është në rikonstruksion të plotë duke përmirësuar aksesin në një nga atraksionet historike në bregdetin e jugut, e duke nxitur mundësi të reja në industrinë e turizmit në këtë zonë.

